UDHËZIM
Nr. 8, datë 10.6.2020

PËR GARANTIMIN E INFRASTRUKTURËS PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË NOTERËVE, QË OFROJNË SHËRBIMIN E TYRE NË NJË BASHKI TJETËR, BRENDA TË NJËJTIT RRETH GJYQËSOR, DHE MËNYRËN E PËRBALLIMIT TË SHPENZIMEVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar; të nenit 10, pika 6, të ligjit nr. 110/2018, "Për noterinë",

UDHËZOJ:

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave për garantimin e infrastrukturës për ushtrimin e veprimtarisë noteriale për noterët e emëruar në një bashki të caktuar, që kryejnë deri në katër ditë shërbim në muaj në një bashki tjetër, brenda të njëjtit rreth gjyqësor, në të cilën nuk vepron asnjë zyrë noteriale, si dhe mënyrën e përballimit të shpenzimeve të tyre.
2. Për të mundësuar ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me kërkesat e ligjit për noterinë, çdo noter i cili caktohet për të kryer shërbimet e noterisë në një bashki tjetër, brenda të njëjtit rreth gjyqësor, duhet të ketë një zyrë, vendndodhja e së cilës duhet të jetë brenda territorit të bashkisë të përcaktuar në urdhrin e ministrit të Drejtësisë.
3. Zyra ku noteri do të ofrojë shërbimin e noterisë, merret në një ndërtesë të paluajtshme private apo publike, me sipërfaqe të mjaftueshme për të lejuar ushtrimin normal të veprimtarisë, sipas përcaktimeve ligjore.
4. Objekti i zyrës noteriale mund të merret me qira, sipas afatit të përcaktuar për ofrimin e shërbimeve noteriale në një bashki tjetër, në përputhje me urdhrin e ministrit të Drejtësisë për caktimin e noterit.
5. Zyra e noterit duhet të ketë hyrje të veçantë.
6. Zyra noteriale nuk mund të jetë pranë objekteve që paraqesin mundësi të mëdha të rrezikut për rënien e zjarrit (magazina me lëndë plasëse, djegëse, pika karburanti) dhe dëmtimin e dokumentacionit.
7. Zyra duhet të jetë e pajisur, me:
a) ndriçim të mjaftueshëm;
b) kompjuter, si dhe elemente të tjera ndihmëse, shërbim interneti 24-orësh dhe llogari elektronike identifikuese, e cila përmban të dhëna mbi *username*, *password* dhe nënshkrim (të dhënat e shenjave të gishtit), me qëllim realizimin e aksesimit në sistemin elektronik të pasurive të paluajtshme;
c) tavolinë të përshtatshme;
ç) ndenjëse;
d) rafte (dollapë) zjarrduruese për mbajtjen e dokumentacionit arkivor dhe të regjistrave;
dh) kasafortë sigurie;
e) pajisje të tjera komunikimi, si: telefon, faks, fotokopje, si dhe çdo mjet tjetër të përshtatshëm që mund t'i shërbejë për kryerjen e veprimtarisë së tyre;
ë) pajisje për fikjen e zjarrit.
8. Mjedisi ku kryhen veprimet noteriale duhet të përmbushë kushtet e domosdoshme për sigurinë, privatësinë dhe konfidencialitetin e komunikimeve me palët.

9. Dosjet, dokumentet dhe shtojcat e tyre duhet të ruhen me qëllim që të sigurohen nga vjedhja, zjarri apo dëmtimi nga ujërat apo lagështira. Sigurimi i zyrës noteriale duhet të jetë në pajtim me dispozitat ligjore, të cilat rregullojnë mbrojtjen nga zjarri.

10. Për kontrollin e zbatimit të përcaktimeve që lidhen me garantimin e infrastrukturës për noterët që ofrojnë shërbimin, sipas parashikimeve të këtij udhëzimi, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë.

11. Financimi i shpenzimeve lidhur me garantimin e zyrës noteriale, si dhe pajisjet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë noteriale, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi, mbulohen nga buxheti i Dhomës Kombëtare të Noterisë.

12. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë dhe noterët.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)